

V E N D I M
Nr.29, datë 30.4.2001

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Hajredin Fuga	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kujtim Puto,	Anëtar i “““
Kristofor Peçi,	Anëtar i “““
Sokol Sadushi,	Anëtar i “““
Zija Vuci,	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, më datën 9.3.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.10 Akti që i përket:

K Ë R K U E S: Ardian Kalia, i përfaqësuar nga avokat Fatmir Tartale.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Këshilli i Lartë i Drejtësisë, i përfaqësuar nga inspektori Adnand Kosova, me akt përfaqësimi.

O B J E K T I:

Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.1066, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Për shfuqizimin si antikushtetues të këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

Ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor që konsiston në këto drejtime:

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendim për shkarkimin e tij nga detyra si gjyqtar, duke marrë pjesë si anëtar edhe zoti Pajtim Hoxha, ndonëse ky ka qenë kryesues i trupit gjykues në një çështje penale të gjykuar nga kërkuesi, për të cilën është diskutuar në mbledhjen e këtij organi se është dhënë dënim i butë dhe se për këtë është ngarkuar vetëm ai me përgjegjësi.

- Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke tejkaluar kompetencat e veta, ka dhënë kundër tij një masë disiplinore më të rëndë nga ajo që ka propozuar Ministri i Drejtësisë.

Nga ana tjetër, për këtë masë ekstreme që ai ka zbatuar, kërkuesi nuk është vënë në dijeni qysh më parë për mundësinë e zbatimit të saj, kështu që është privuar nga e drejta për të organizuar një mbrojtje të përshtatshme.

- Në kundërshtim me çdo parim, është ndëshkuar kryesisht për gjykime të padrejta edhe në ato çështje, vendimet e të cilave, në kohën kur është bërë kontrolli nga Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kishin marrë formë të prerë.

- Nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimi për lënien në fuqi të kësaj mase disiplinore të zbatuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është shpallur i paarsyetuar. Arsyetimi i tij pas 1 (një) muaji, vjen në kundërshtim me nenin 142 pika 1 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin zotin Zija Vuci, kërkuesin dhe përfaqësuesin e tij, përfaqësuesin e subjektit të interesuar dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesi Ardian Kalia, me vendim nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, është shkarkuar nga detyra si gjyqtar i shkallës së parë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me motivacionin e “kryerjes së veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës”, vendim ky që është lënë në fuqi me vendimin nr.1066, datë 01.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Gjykata Kushtetuese, duke analizuar shkaqet për të cilat ai ka kërkuar shfuqizimin e këtyre

vendimeve, konstaton se vetëm njëri nga këto shkaqe meriton të merret në konsideratë, sepse është i mjaftueshëm për pranimin e kërkesës.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, vendimin e tij për shkarkimin nga detyra të kërkuarit, e ka mbështetur në vlerësimet negative që i ka bërë grupi i inspektorëve vetëm gjashtë vendimeve gjyqësore të dhëna nga kërkuari, ose si gjyqtar i vetëm, ose si anëtar i trupit gjykues me gjyqtarë të tjerë. Del se nga këto vendime, katër prej tyre kanë marrë formën e prerë, tre që nuk janë ankimuar dhe një tjetër që është lënë në fuqi nga instancat gjyqësore më të larta; ndërsa dy vendime të tjerë janë ndryshuar nga Gjykata e Apelit, por vetëm për masën dhe jo për llojin e dënimit.

Në përgjithësi, vërejtjet për këto vendime nuk kanë të bëjnë me shkelje të karakterit procedural, por vetëm me zbatim të gabuar të ligjit material, i cili sipas konkluzioneve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është reflektuar kryesisht, në caktimin e masave të buta të dënimit me burgim, në një rast në cilësimin ligjor jo të drejtë të veprës penale; ndërsa në një rast tjetër, në zgjidhjen e gabuar të një çështjeje civile. Del se evidentimi i këtyre shkeljeve është realizuar jo në rrugën e verifikimit të ankesave të shtetasve, siç parashikon neni 17 i ligjit “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”, por nëpërmjet kontrollit të përgjithshëm që ka ushtruar Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi veprimtarinë njëvjeçare të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe këto janë konsideruar si shkelje të disiplinës në punë të kryera në formën e veprimeve që vijnë në kundërshtim me përmbytjen e rregullt të detyrës nga ana e kërkuarit.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, duke i hyrë vlerësimit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të këtyre vendimeve gjyqësore të dhëna nga kërkuari në një kohë që këto kishin marrë formë të prerë, ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e nenit 135 pika 1 të Kushtetutës.

Kjo dispozitë, e cila bën dallimin midis gjyqtarëve sipas funksioneve, ka për qëllim t’i shkëpusë ata nga varësia hierarkike dhe t’ia nënshtrojë veprimtarinë e tyre në dhënien e drejtësisë, vetëm kontrollit të instancave më të larta gjyqësore, sipas rregullave të përcaktuara në Kodet e Procedurave.

Vendimet gjyqësore të formës së prerë, për çështjen konkrete që zgjidhin, kanë fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se përsa kohë ato nuk janë prishur ose ndryshuar nga një gjykatë më e lartë, asnjë organ tjetër shtetëror nuk mund të mos përfillë përmbajtjen e tyre dhe të ngarkojë me përgjegjësi gjyqtarin e çështjes.

Megjithatë, problemi ndryshon në rastet kur këto vendime janë shoqëruar me shkelje që diskreditojnë rëndë pozitën ose figurën e gjyqtarit dhe që cenojnë në përgjithësi prestigjin dhe autoritetin e pushtetit gjyqësor.

Në raste të tilla, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka kompetenca të plota të marrë çdo lloj mase disiplinore ndaj gjyqtarëve, pa e kondicionuar atë, me faktin nëse kjo kategori vendimesh kanë marrë formë të prerë dhe kanë fituar kështu autoritetin e gjësë së gjykuar. Madje, ndaj akteve të kësaj natyre të kryera gjatë ushtrimit të detyrës, ai mund të reagojë në çdo kohë edhe kur nuk ka përfunduar shqyrtimi i çështjes.

Por, në përzgjedhjen e masës disiplinore të zbatuar ndaj kërkuarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, nuk ka pasur sa duhet parasysh edhe kërkesat e nenit 147 pika 6 të Kushtetutës.

Sipas kësaj dispozite, shkarkimi nga detyra i gjyqtarit vendoset vetëm në raste të caktuara, midis të tjerash edhe për shkelje të ndryshme të disiplinës në punë, të kryera këto në ndonjë nga format e parashikuara në ligjin nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”.

Megjithatë, jo çdo shkelje, qoftë kjo e kryer edhe në formën e veprimeve në kundërshtim me përmbajtjen e rregullt të detyrës, përlligj marrjen e kësaj mase ekstreme.

Zbatimi i saj, në vështrim të dispozitës kushtetuese të lartpërmendur, është e lidhur vetëm me kryerjen e akteve që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit.

Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar çështjes në shqyrtim, konstaton se Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ashtu si edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë argumentuar se cilat janë shkaqet e vërteta të shkeljeve që i atribuohen kërkuarit. Me fjalë të tjera, ata nuk janë shprehur nëse këto mangësi në punën e kërkuarit janë rezultat i veprimeve me dashje që diskreditojnë pozitën e tij si gjyqtar apo janë gabime të zakonshme që mund të kenë ardhur nga mungesa e përvojës së tij në këtë detyrë.

Sqarimi i këtyre rrethanave, në këtë rast, ishte i domosdoshëm për shkak se kërkuari është ngarkuar me përgjegjësi, kryesisht për dhënien e dënimeve të buta ose për zbatim të gabuar të ligjit material në çështje që pjesa më e madhe e tyre kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, pasi

nuk dihet me siguri nëse këto shkelje do të vlerësoheshin të tilla edhe nga instancat gjyqësore më të larta, në rast se këto vendime do t'i nënshtroheshin kontrollit të tyre të zakonshëm gjyqësor.

Në këto rrethana, përveç vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, duhet të shfuqizohet edhe vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me të cilin është përligjur rezultati i këtij procesi të parregullt disiplinor të zhvilluar kundër kërkuesit.

Përsa i përket argumenteve të tjera të paraqitura nga kërkuesi, Gjykata Kushtetuese çmon se ato nuk kanë ndikuar në dhënien e këtyre vendimeve dhe për këtë shkak nuk i merr për bazë.

Kështu, pjesëmarrja në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë e një anëtarit të tij, për të cilin kërkuesi ka shprehur rezerva ose dyshime për njëanshmëri, në fakt nuk i ka ndryshuar dhe as ka patur mundësi t'i ndryshonte rrjedhën këtij procesi disiplinor, duke e drejtuar atë kundër ose në favor të tij. Kjo për arsye se nga provat shkresore del që të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë kanë votuar për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, me përjashtim të kryetarit dhe të një anëtarit tjetër të këtij organi, të cilët kanë abstenuar.

E së njëjtës natyrë është edhe shkelja tjetër e pretenduar nga kërkuesi në lidhje me arsyetimin e vendimit nga ana e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pas një muaji nga data e shpalljes. Edhe kjo shkelje nuk ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes, përderisa është kryer pas shpalljes së asaj që është vendosur, aq më tepër që kërkuesi nuk ka ngritur ndonjë pretendim për ekzistencën e ndonjë kundërrthënie midis asaj që është shpallur dhe përmbytjes së këtij vendimi.

I pabazuar, në dallim nga dy pretendimet e sipërme të kërkuesit, është ai që ka lidhje me ashpërsimin e masës disiplinore të zbatuar ndaj tij nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, e krahasuar kjo me atë të propozuar nga Ministri i Drejtësisë.

Në për zgjedhjen e këtyre masave, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka kompetenca të plota dhe nuk është aspak i lidhur me ato të propozuara nga Ministri i Drejtësisë.

Po ashtu, i pambështetur është edhe pretendimi tjetër i kërkuesit se nuk i janë krijuar kushtet për të organizuar si duhet mbrojtjen e tij, për shkak se nuk i është komunikuar në kohë edhe mundësia e marrjes ndaj tij të masës së shkarkimit nga detyra.

Përkundrazi, nga materiali i çështjes del se për të gjitha shkeljet që i janë atribuar dhe që është gjykuar, ai është njoftuar rregullisht 10 ditë përpara se të mblidhej Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Kjo kohë ka qenë për të mëse e mjaftueshme dhe ai s'ka pasur asnjë lloj pengese që të ndërtonte një mbrojtje të përshtatshme ndaj çdo mase disiplinore që eventualisht mund të zbatohet kundër tij.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.1066, datë 1.11.2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe nr.87, datë 15.7.2000 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Dërgimin e çështjes për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.